**UNIVERSITETI I MITROVICËS**
**UNIVERSITY OF MITROVICA**
**"ISA BOLETINI"**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
http/www.umib.net; Tel: +381-28535725/535727


Rektor i UMIB-it
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 2233
Dt 07.11.2019

Në bazë të nenit 48, pika 1.3, të Statutit të Përkohshëm, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 7.11.2019, mori:

**VENDIM**

I. Për shpalljen e konkursit për rizgjedhje-avansim të personelit akademik dhe vende të reja pune (asistentë dhe profesorë) në njësitë akademike të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", sipas propozimeve të njësive akademike.

II. Konkursi për zgjedhjen e personelit akademik në njësitë akademike të UMIB-it do të hartohet në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë, Ligjin e Punës, Statutin e Përkohshëm të Universitetit dhe Rregulloren për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes, avancimit dhe emërimit të personelit akademik në UMIB dhe aktet e tjera normative në fuqi që kanë të bëjnë me themelimin e marrëdhënies së punës për stafin akademik.

III. Pjesë e këtij vendimi është edhe konkursi i hartuar në bazë të propozimit të njësive akademike.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi t'i dërgohet:
1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;
3. Drejtorit te zyrës për çështje akademike.
4. Zyrës së personelit

Prof. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it